



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:032484
Datë: 22.01.2024
Numri i dokumentit: 05222773

C-IV-17-0436

Parashtruesja e ankesës: Sh S të cilin e përfaqëson sipas autorizimit H P avokat nga Prishtina.

Kundër

Palës kundërshtare: Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën; 22.01.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

1. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e parashtruar nga Sh S vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj vendimi me shkrim me numër PRN142-0188, i datës 17.05.2017, i lëshuar nga AKP.
2. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 31.08.2017, pranë DHPGJS, është parashtruar ankesë nga Sh S në emër të N S kundër palës kundërshtare Agjencisë Kosovare të Privatizimit ndaj vendimit me shkrim me numër PRN142-0188, të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e parashtruesit të ankesës për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën e pa specifikuar nga NSH Rilindja Gazeta (në likuidim).

Parashtruesja e ankesës ndër të tjera ka theksuar se pranë Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë kreditore me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga muaji maj 1998, e deri në muajin mars 1999 €, në shumën prej 2,095.00 € dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit për dorëzimin e kërkesave. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën kreditore dhe me vendimin me numër PRN142-0188, kërkesën për kompensim e ka refuzuar si të pa bazuar me pretendimin se kërkesa kreditore është e parashkruar.

Me tutje ka theksuar se qëndrimi juridik i palës kundërshtare se kërkesa është e parashkruar është i pa bazuar. Vendimi i Autoriteti të Likuidimit është kontradiktor kjo vërtetohet në faktin se në vendim thuhet se kërkesa është dorëzuar brenda afatit për dorëzimin e kërkesave, ndërsa në anën tjetër thuhet se kërkesa është parashkruar.

Po ashtu vendimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, sipas dispozitave ligjore kur kërkesa është e parashkruar ajo refuzohet e nuk mund të vlerësohet si e pa vlefshme siç ka vepruar Autoriteti i Likuidimit në rastin konkret.

Po ashtu ka theksuar se në bazë të nenit 383 të LMD-së parashkrimi nuk rrjedh gjatë kohës kur kreditori nuk ka pasur mundësi për shkak të pengesave të pa përballueshme për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave në rrugën gjyqësore. Me fillimin e procedurës së likuidimit ndërpritet rrjedha e afatit të parashkrimit dhe se kërkesa kreditore nuk ka mundur të jetë e parashkruar deri me datën 22.02.2017. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që ankesën ta aprovoj si të bazuar të shfuqizoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit me numër PRN142-0188, dhe të detyrohet pala kundërshtare që në emër të kompensimit të 11 pagave për periudhën nga muaji maj 1998, e deri në muajin mars 1999, t'ia kompensoj shumën prej 2,095.00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kësaj ankesa parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- *Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN 142-0188, me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensim të pagave në procedurë të likuidimit;*

Me datën 25.09.2017, AKP-ja përmes përfaqësuesit të sajë ka paraqitur mbrojtjen ndaj ankesës së parashtruar nga Sh S,ku ndër të tjera ka theksuar se NSH Rilindja Gazeta (në likuidim), ka hyrë në procedurën e likuidimit me datën 22.02.2017. Me datën 20.04.2017, parashtruesja e ankesës ka parashtruar një kërkesë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e 11 pagave të pa paguara për periudhën e pa specifikuar. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga e njëjta në atë procedurë dhe me vendimin me numër PRN142-0188, kërkesën e parashtruar nga parashtruesja e ankesës e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar. Vendimin e vet Autoriteti i Likuidimit e ka bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Me tutje në mbrojtjen e parashtruar ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe drejtë ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. Po ashtu ka theksuar se në bazë të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034, dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar kërkesa e parashtruar nga parashtruesja e ankesës është e parashkruar. Ankuesja në ankesën e parashtruar ka theksuar se ka pasur pengesa të pa përballueshme për të kërkuar mbrojtje gjyqësore të të drejtave të saj duke u thirrur në nenin 383 të LMD-së, mirëpo nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë ato pengesa. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me pohim borxhi as me dorëzim të padisë dhe se kërkesa kreditore është e parashkruar.

Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që ankesën e parashtruar nga Sh S ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës, gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se ankesa e parashtruar në këtë çështje juridike është e pa bazuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve, parashtrimeve dhe provave të lëndës gjykata ka gjetur se parashtruesja e ankesës me datën 20.04.2017, ka parashtruar një kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e 11 pagave për periudhën e pa specifikuar. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga e njëjta në atë procedurë dhe me vendimin me numër PRN142-0188, kërkesën e parashtruar nga Sh S e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar. Vendimin e vet Autoriteti i Likuidimit e ka bazuar në nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Parashtruesja e ankesës në ankesën e parashtruar ka pretenduar se bashkëshorti i saj ka qenë punëtor në Ndërmarrjes dhe nuk është kompensuar për periudhën nga muaji maj 1998, e deri në muajin mars 1999, dhe se shuma të cilën pala kundërshtarë ka për detyrim që t'ia kompensoj është në vlerë prej 2,095.00 €. Në anën tjetër pala kundërshtarë e ka kontestuar ankesën duke thekuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës ngase parashtruesja e ankesës në lidhje me pagat e pa paguara të pretenduara nuk i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent tri vite nga dita e arritjes së kërkesës që është viti 2008.

Fillimisht objekt i shqyrtimit nga gjykata ishte çështje e parashkrimit të ngritur nga pala e paditur me përgjigje në padi. Ku nga provat e shqyrtuara gjykata ka konstatuar se parashtruesja e ankesës pretendon në paga që i referohen periudhës 1998-1999, dhe nuk ka prezantuar prova që dëshmon se i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi kompetent në lidhje me borxhin e pretenduar.

Kërkesën pranë Autoriteti të Likuidimit e ka parashtruar me datën 20.04.2017. Me nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se “kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”.

Në rastin konkret në kuptim të dispozitës së lartë cekur gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesa e pretenduar e parashtrueses së ankesës për kompensim të pagave është e parashkuar.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës secila palë do ti heqë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit prej 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi